



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 4, Datë 20. 02. 2017

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK  
TË TIRANËS NR.84, DATË 29.12.2016, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESËM 2017-2019 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR  
VITIN 2017”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b” e pika 1/1.3, shkronja “c”, nenit 34, pika 6, nenit 40, pika 4, nenit 54, shkronja “dh” dhe nenit 55 pikat 3 dhe 6 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); nenit 44, paragrafi i dytë, shkronja “a” të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”(i ndryshuar); Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.8 datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84 datë 29.12.2016 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të investimeve brenda Programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik dhe Programit të Shërbimeve Publike Vendore për vitin 2017, sipas tabelës nr. 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të investimeve brenda Programit të Shërbimeve Publike Vendore për vitin 2017, sipas tabelës nr. 2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë detajimin e fondeve të investimeve brenda Programit të Shërbimeve Publike Vendore për vitin 2017, sipas tabelës nr. 3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike si dhe Agjensia e Parqeve dhe Rekreacionit.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**